

# Arsimimi

KULTURA E NJERIUT

*Ë-buletin*

**Nëntorë, 2016**

Shtohen angazhimet lidhur me Ligjin e viteve të 90-ta

**Kryeministri Mustafa shpreh përkushtimin e tij në takim me SBASHK-un**



SBASHK-u ka kohë që është duke u angazhuar përmes takimeve me përfaqësues të institucioneve dhe të subjekteve politike që janë pjesë e Parlamentit të Kosovës të bashkërendisin angazhimet për të realizuar kërkesën e anëtarësisë së SBASHK-ut lidhur me Projektligjin për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet shkollore 1990/91 e deri 1998/99. Në kuadër të këtyre përpjekjeve është zhvilluar edhe takimi me Kryeministrin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, z. Isa Mustafa ... (faqe 5)

Në ambientet e MASHT kanë nisur takimet lidhur me ligjin e viteve të 90-ta

**U bisedua për çështje të përgjithshme të këtij ligji**



Janë takuar në ambientet e MASHT-it znj Mebera Mustafa përfaqësuese e Kabinetit të... (faqe 5)

U organizua punëtori tri ditore e Këshillit Drejtues

**Përpjekje për përgatitjen sa më të mirë të Kontratës së re Kolektive**

Përfaqësues të SBASHK-ut në takimet e vazhdueshme me Ministrin Bajrami, përveç për shumë çështje aktuale, kishin....(faqe 6)

Intervistë me anëtarin e SBASHK-ut, znj. Indira Haliti

**Jam bindur se SBASHK-u mbron të drejtat e anëtarësisë**

Indira punon në kopshtin e parashkollores në Mamushë. Pushteti lokal kishte tentuar t'ia shkel të drejtat elementare dhe pa as edhe një arsye ta largoj nga vendi i punës.... (faqe 3)

*Ministri Kujtim Shala u takua me përfaqësues të SBASHK-ut*

**Angazhime të përbashkëta, jo vetëm në sferën e kulturës**



Ministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z.Kujtim Shala vazhdon takimet me përfaqësues të SBASHK-ut ... (faqe 7)

## Editorial

### Nëntori i kujtesës historike



Ngjarjet e mëdha në historinë e popullit tonë nëpër shekuj, disi sikur janë radhitur në muajt e caktuar. Njëri nga muajt që bartë kujtime e ngjarje është muaji nëntor. Sa herë vjen ky muaj shpalosen kujtimet nëpër vite, dekada e nëpër shekuj. Ky muaj na obligon të lartësojmë kujtimin për pishtarët e kulturës e gjuhës sonë që i dhanë gjuhës sonë alfabetin. Lartësojmë kujtimin për Komandantin legjendar Adem Jashari dhe për plakun e urtë Ismajl Qemajli. Ky muaj nxjerr në kujtesën tonë edhe atdhetarin e

trimin e madh të Kosovës Isa Boletini. Muaji nëntor është pra muaj i krenarisë shqiptare.

Në këtë muaj, por edhe gjatë gjithë vitit duhet të mbajmë të gjallë kujtesën për datat e ngjarjet e të obligohemi që për hir të së kaluarës plot dhembje e gjak e në respekt të veprave të mëdha atdhetare të personaliteteve të ndritura të historisë të punojmë edhe më shumë për arsimin, kulturën e për ardhmërinë e atdheut tonë.

Duhet t'i lëmë meritë e mendimet e liga dhe të bashkojmë dijen e forcën në emër të atdheut e ardhmërisë së brezave. Duhet të mbajmë mend thënien se: "Më i mirë se i miri është ai që e përkrah dhe i ndihmon të mirin".

Të punojmë bashkë e në SBASHK për arritje të reja për hir të nëntorit, marsit dhe ngjarjeve që bartin këta e muajt tjerë të historisë sonë të lavdishme.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

[www.sbashk-rks.org](http://www.sbashk-rks.org)

Mos hezitoni të na jepni sygjerrime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

**Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)**

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.


Email: [info@sbashk-rks.org](mailto:info@sbashk-rks.org)

Tel. +381(0)38/ 226 940



*Intervistë me anëtarën e SBASHK-ut, znj. Indira Haliti*

### Jam bindur se SBASHK-u mbron të drejtat e anëtarësisë



*Indira punon në kopshtin e parashkollores në Mamushë. Pushteti lokal kishte tentuar t'ia shkel të drejtat elementare dhe pa as edhe një arsye ta largoj nga vendi i punës. Indira kishte guxim qytetar dhe e ngriti këtë çështje. SBASHK-u iu bë krah dhe e drejta triumfoi. “ U*

*binda se SBASHK-u u angazhua fuqishëm dhe me vendosmëri duke e ngritur zërin , me angazhim maksimal. I jam falënderuese dhe mirënjohëse shumë në realizimin e të drejtës sime”, shprehet në intervistën për gazetën tonë, znj. Haliti.*

Arsimimi sot

**Kush është Indira Haliti?**

Indira

Indira Haliti e lindur në 08.08.1984 në Krushë të Madhe , shkollën fillore dhe të mesme e kam kryer në fshatin tim. Studimet i vazhdova në Prizren, në Fakultetin e Edukimit në Departamentin e Gjuhës dhe Letërsisë shqipe ne vitin 2007, po ashtu e diplomuar edhe në Fakultetin e Edukimit, në Departamentin e Parashkollores.

Arsimimi sot

**Kur jeni punësuar dhe kur jeni bërë anëtare e SBASHK-ut?**

Indira

Jam punësuar në vitin 2007 në Shkollën fillore “ Ardhmëria “ në Rahovec ku aty kam punuar dy vite e gjysmë si mësuese klasore. Në shtator të vitit 2010 jam punësuar në kopshtin e parashkollores “ Zybeide Hanim “ në Mamushë dhe aktualisht duke punuar.

Ne shkollën Ardhmëria kemi qenë anëtar të SBASHK, por kur jam punësuar në Mamushë mësimdhënësit e këtij institucioni nuk kanë qenë të anëtarësuar në sindikatë, unë dhe disa koleg kemi shpreh dëshirë dhe vullnet që të anëtarësohemi dhe shumica e

mësimdhënësve të këtij institucioni kanë shprehur vullnetin dhe dëshirën për t'u anëtarësuar, në vitin 2015.

Arsimimi sot

**Gjatë këtyre viteve të punës, a keni pasur shkelje të të drejtave të punës nga punëdhënësi dhe nëse po, a mund t'i përshkruani në pika të shkurta shkeljet që iu janë bërë?**

Indira

Po unë kam pas shkelje të të drejtave të punës në këtë vit, Drejtoria Arsimit në Mamushë ma kanë njoftuar me një njoftim të më ndërkrehet marrëdhënia e punës dhe të hiqem nga lista e pagave.

Në njoftim kanë cekur se kanë pasur një ankesë të prindërve dhe të nënkryetares së komunës , kinse unë s'kam pasur sukses, kam munguar dhe kam pasur sjellje të keqe. Pra, mua më është ndërprerë marrëdhënia e punës që nga muaji Tetor, duke mos u bazuar në asnjë dispozitë ligjore konform rregullave dhe ligjeve të Republikës së Kosovës , të gjitha këto kanë qenë shpifje ndaj meje dhe aspak të vërteta gjë që më vonë është vërtetuar nga Institucionet përkatëse.

Arsimimi sot

**A mund të tregoni hapat e ndërmarrë për të realizuar të drejtën tuaj?**

Indira

Hapi i parë që kam ndërmarrë ka qenë ankesa nga ana ime drejtuar Drejtorisë së komunës, informimi i medieve dhe takimi me kryetarin e sindikatës së SBASHK-ut Z. Rrahman Jasharaj dhe Ymer Ymerin dhe informimi mbi parregullsitë që më janë bërë mua.

Hapi tjetër ka qenë ankesa drejtuar institucioneve si Inspektoratit të punës dhe Inspektoratit të Arsimit me qendër në Prizren .

Arsimimi sot

**Gjatë kësaj kohe të kërimit të realizimit të drejtës tuaj, a keni qenë e mbështetur nga SBASHK-u dhe çka konkretisht ka bërë SBASHK-u për ju?**

Indira

Gjatë kësaj kohe kam gjetur mbështetjen e SBASHK-ut duke i angazhuar gjitha forcat dhe kompetencat për ta realizuar drejtën time .

SBASHK-u ka ndërmarr hapa duke ju drejtuar Inspektoratit të Arsimit në Prishtinë dhe po ashtu ju është drejtuar Drejtorisë komunale në Mamushë me një kërkesë dhe Kuvendit Komunal , Kryetarit Z. Arif Bytyq .Po ashtu i është drejtuar dhe Drejtorit të Departamentit të Inspektimit në MASHT , z. Dëfrim Gashi.

SBASHK-u ka reaguar fuqishëm duke mbrojtur të drejtat e mia duke më mbështetur deri në pikën e realizimit të së drejtës sime .

Arsimimi sot

**Kur jeni bërë anëtare, a keni menduar ndonjëherë që te SBASHK do të gjeni një mbështetje të tillë?**

Indira

Ta them të drejtën kur jam bërë anëtare nuk kam menduar që do më dalin problem të tilla as që e kam quar në mend një gjë të tillë. Nuk kam e kam menduar që SBASHK-u ngreh zërin aq fuqishëm për anëtarët e vet dhe mësimdhënësit . Mirëpo u binda se SBASHK-u u angazhua fuqishëm dhe me vendosmëri duke e ngritur zërin , me angazhim maksimal. I jam falënderuese dhe mirënjohëse shumë në realizimin e të drejtës sime .

Arsimimi sot

**Çka do të iu sugjeronit kolegëve tuaj që hezitojnë të anëtarësohen në SBASHK dhe atyre që janë anëtarë dhe hezitojnë të paraqesin ankesat kur iu bëhen shkelje të të drejtave të tyre?**

Indira

Të gjithë kolegëve të mi ju sugjeroj të anëtarësohen në SBASHK , në mënyrë që aty të jemi të bashkuar ta ngritim zërin së bashku. Me anëtarësimin e gjithë kolegëve SBASHK do të fuqizohet dhe zëri ynë do të jetë I fuqishëm , të drejtat tona më nuk do të shkelën .Të gjithë ata që mendojnë që ju janë bërë padrejtësi ju sugjeroj ti drejtoheni me ankesa SBASHK-ut dhe gjitha institucioneve relevante për t'i mbrojtur të drejtat e tyre.

Arsimimi sot

**Cili është mesazhi juaj për kolegët kudo në Kosovë?**

Indira

Unë ju drejtohem gjithë kolegëve mësimdhënësit të punojnë me nder, përgjegjësi, përkushtim dhe respekt për profesionin e tyre .Ky profesion është një mision që na është besuar dhe besoj se secili ndihet krenar me punën e tyre fisnike , njëherit ju them mjaft mësuesi ka qenë i nëpërkëmbur , luftoni për të drejtën tuaj mos lejoni të ju nëpërkëmbin njerëz që shfrytëzojnë pozita politike , mos politizoni arsimin të vetmin që i përballoi çdo furtune dhe sfide në këtë pozitë të vështirë ekonomike e sociale.

## Gjatë muajit

Shtohen angazhimet lidhur me Ligjin e viteve të 90-ta

### Kryeministri Mustafa shpreh përkushtimin e tij në takim me SBASHK-un

SBASHK-u ka kohë që është duke u angazhuar përmes takimeve me përfaqësues të institucioneve dhe të subjekteve politike që janë pjesë e Parlamentit të Kosovës të bashkërendisin angazhimet për të realizuar kërkesën e anëtarësisë së SBASHK-ut lidhur me Projektligjin për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet shkollorë 1990/91 e deri 1998/99. Në kuadër të këtyre përpjekjeve është zhvilluar edhe takimi me Kryeministrin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, z. Isa Mustafa.



Në këtë takim kanë marrë pjesë Ministri i MASHT, Prof. dr. Arsim Bajrami me këshilltarin e tij z. Azem Guri dhe kryetari i SBASHK-ut, z. Rrahman Jasharaj dhe menaxheri për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm, z. Ymer Ymeri.

Ministri Bajrami bashkë me delegacionin e SBASHK-ut kanë informuar Kryeministrin Mustafa për situatën në arsim duke u ndalur te çështja e Projektligjit për statusin e mësimdhënësve shqiptar të Republikës së Kosovës për vitin shkollor 1989/90 e deri në vitin

shkollor 1998/99. Ishte kërkesë e përbashkët drejtuar Kryeministrit që të bëhen angazhime konkrete të Kabinetit të tij për t'u adresuar drejtë çështja e këtij ligji.

Kryeministri Mustafa është shprehur se edhe Qeveria dhe gjithë institucionet ndjejnë obligim që të bëjnë gjithë të mundurën për të shprehur respektin e merituar dhe përkrahjen përmes Ligjit për gjithë mësimdhënësit e

viteve të 90-ta që kanë punuar me përkushtim e sakrifica për arsimin në ato vite të vështira. Kryeministri Mustafa ka shprehur pajtim të plotë me kërkesën e SBASHK-ut dhe gjatë bisedës përmbajtësore janë pajtuar të dy palët që javën e ardhme Ministrat Hoti, Abrashi dhe Bajrami bashkë me përfaqësues të SBASHK-ut të ulen dhe të zhvillojnë dialog të sinqertë lidhur me këtë çështje në mënyrë që të arrihet marrëveshje dhe që pastaj ligji të procedohet nga Qeveria për në Parlament për t'u votuar në mënyrë që pastaj të nis edhe implementimi i tij.

Në ambientet e MASHT kanë nisur takimet lidhur me ligjin e viteve të 90-ta

### U bisedua për çështje të përgjithshme të këtij ligji

Janë takuar në ambientet e MASHT-it znj. Mebera Mustafa përfaqësuese e Kabinetit të Kryeministrit Isa Mustafa, z. Azem Guri, përfaqësues i MASHT-it, z. Izet Shala, përfaqësues i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies dhe z. Ymer



Ymeri përfaqësues si SBASHK-ut duke shënuar kështu fillimin e takimeve të përbashkëta lidhur me Ligjin për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99. Në këtë takim nuk

ka qenë i pranishëm përfaqësuesi i Ministrisë së Financave edhe pse ishte konfirmuar pjesëmarrjen e tij në këtë takim. Ky takim ka hapur raundin e takimeve lidhur me këtë ligj dhe pasi ishte i pari në këtë përbërje ka pasur karakter konsultativ.

Palët e pranishme kanë biseduar për çështje të përgjithshme të Ligjit, por nuk është biseduar për deklaratën financiare të këtij ligji pa



Projektligji të konkretizohet dhe të merr rrugën drejt Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës për miratim.

qenë i pranishëm përfaqësuesi i Ministrisë së Financave.

Në takimin e radhës pritet të merr pjesë edhe përfaqësuesi i MF-së dhe kështu do të kalohet në çështje konkrete. SBASHK-u shpreson se takimet do të vazhdojnë dhe se të gjitha palët do ta japin kontributin konkret që

## *Ministri Kujtim Shala u takua me përfaqësues të SBASHK-ut* **Angazhime të përbashkëta, jo vetëm në sferën e kulturës**

Ministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z.Kujtim Shala vazhdon takimet me përfaqësues të SBASHK-ut në përpjekjet e përbashkëta për të gjetur zgjidhje për çështjet aktuale, jo vetëm në sferën e kulturës. Në hapje të këtij takimi kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj ka



falënderuar Ministrin Shala për angazhimet e tij në zgjidhjen e gjithë çështjeve me dialog. Ai pastaj i ka treguar Ministrit Shala për përmbajtjen e takimit me Kryeministrin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Isa Mustafa lidhur me Ligjin për statusin e mësimdhënësve të viteve të 90-ta. Kryetari i SBASHK-ut edhe në këtë takim ka kërkuar angazhim edhe në të ardhmen të Ministrit Shala për të gjetur një

zgjidhje sa më të shpejtë e sa më korrekte për këtë çështje.

Ministri Shala është shprehur i gatshëm që të shtohet bashkëpunimi në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm për këtë kategori të punëtorëve.

Po në këtë takim është bashkëbiseduar rreth çështjes së përgatitjes së Kontratës

Kolektive për sektorin e kulturës dhe ishte pajtueshmëri e të dy palëve që një komision i SBASHK-ut, që do ta përbëjnë edhe njerëz nga sektori i kulturës ta punojë draftin e Kontratës Kolektive për Kulturën e pastaj të zhvillohen takime me komisionin e Ministrisë së Kulturës për t'u arritur pajtueshmëri e dy anshme në mënyrë që pastaj kontrata të nënshkruhet nga Ministri Shala dhe kryetari i SBASHK-ut, Jasharaj.

U organizua punëtori tri ditore e Këshillit Drejtues


## **Përpjekje për përgatitjen sa më të mirë të Kontratës së re Kolektive**

Përfaqësues të SBASHK-ut në takimet e vazhdueshme me Ministrin Bajrami, përveç për shumë çështje aktuale, kishin biseduar edhe për çështjen e Kontratës

së re Kolektive. Ata janë pajtuar që nëse ka praktika të tilla edhe në shtetet tjera të Evropës, atëherë të përgatitet një Kontratë, që vlen për të gjitha nivelet e



arsimit, pra edhe për Universitetin. Në këtë kuadër një komision i SBASHK-ut, i ndihmuar edhe nga disa veprimtarë kanë përgatitur një draft final të kontratës së re.



Me qëllim që Kontrata të jetë sa më mirë e përgatitur dhe që në të të përfshihen gjithë çështjet e rëndësishme për anëtarësinë, u organizua një punëtori tri ditore e Këshillit Drejtues lidhur me këtë dhe çështje të tjera me rëndësi. Në fillim të këtij aktiviteti u mbajt edhe mbledhja e Këshillit Drejtues dhe në të u debatua për gjithë



çështjet aktuale e po ashtu edhe u aprovuan shpenzimet janar-tetor dhe Projekt buxheti i SBASHK-ut për vitin 2016. Në këtë takim është bërë vlerësimi i aktiviteteve, duke filluar nga shoqatat sindikale, të niveli komunal, në Universitete e deri të niveli qendror.



Pas kësaj është bërë analiza nga neni në nen i Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës dhe pastaj Këshilli Drejtues me votën e tyre ka dhënë dritën e gjelbër tekstit final, i cili do të dorëzohet në MASHT.

Edhe një angazhim i SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë

## Kërkesë zyrtare komunave që të zbatohet Kontrata Kolektive



Duke u përgjigjur në letrën e SBASHK-ut për adresimin e kërkesave konkrete nga Kontrata Kolektive dhe atyre që ka shtruar SBASHK-u në vazhdimësi, Ministri i MASHT-it ka bërë angazhime konkrete dhe në përgjigjen e tij

ka treguar se ua ka bërë me dije në takime me kryetarët e komunave dhe me drejtorët e DKA-ve se ata janë punëdhënës dhe se kanë obligim të angazhohen konkretisht për realizimin e çështjes së udhëtimit dhe pikave tjera për të cilat i obligon Kontrata Kolektive e Arsimit Parauniversitar. Pasi që shumë nga komunat edhe pas kësaj nuk kanë reflektuar, SBASHK-u ka vazhduar me angazhimet

që çështjet të zgjidhen me marrëveshje dhe prandaj edhe ka përgatitur e ka dërguar te pushtetet lokale shkresa zyrtare duke kërkuar që qeveritë lokale të kryejnë obligimet e tyre sipas Kontratës Kolektive dhe duke u dhënë punëtorëve të arsimit nga Komunitet e tyre të pensionuar në vitet 2015 e 2016 shpërblimet jubilarë dhe tri pagat me rastin e pensionimit. Në këto

shkresa SBASHK-u ka përmendur gjithë argumentet dhe faktet dhe se pret reflektim pozitiv të qeverive lokale nga komunitet e Kosovës, të cilat është mirë të ndjekin shembullin e mirë të komunitet së Kastriotit (Obiliqit), komunitet kjo e cila ua ka dhënë nga tri paga të punësuarve në arsimin e komunitet së tyre, që janë pensionuar në vitin 2015 dhe në atë 2016.

MASHT-i organizoi Konferencën "Prezantimi i Dokumenteve kurrikulare dhe udhërrëfyese për zbatim"

## Në këtë aktivitet mori pjesë edhe SBASHK-u

Në vazhdim të aktivitetit lidhur me kurrikulin e ri MASHT-i ka organizuar edhe Konferencën "Prezantimi i Dokumenteve kurrikulare dhe udhërrëfyese për zbatim".

Ministri Prof.dr. Arsim Bajrami në fjalën e tij hyrëse ka përshëndetur përfaqësuesit diplomatik ndërkombëtarë, përfaqësuesit e partnerëve ndërkombëtar të arsimit, përfaqësuesit e SBASHK-ut, të DKA-ve dhe të shkollave pilotë të kurrikulit të ri. Në vazhdim të fjalës së tij Ministri Bajrami ka vlerësuar si një arritje të madhe të arsimit në Kosovë finalizimin e rishikimit të dokumenteve kurrikulare të pilotuara në 95 shkolla të Republikës së Kosovës. Duke përshëndetur këtë aktivitet, Zv/ Ministri në MASHT, z.Agim Bërdyna ka shprehur falënderimet për të gjithë, qofshin persona e institucione vendore a ndërkombëtare, që ishin angazhuar me përkushtim lidhur me Kurrikulin e ri.



Edhe ushtruesi i detyrës së sekretarit të përgjithshëm në MASHT, z. Alush Istogu, UD i Drejtorit të Departamentit për zhvillim të arsimit, z.Mustafë

Kadriu dhe z.Selim Mehmeti kryesues i KSHLM-së kanë folur për rëndësinë e angazhimeve lidhur me Kurrikulin e ri.

Delegacioni i SBASHK-ut edhe gjatë zhvillimit të kësaj Konference është takuar me përfaqësues institucionesh dhe me Ministrin Bajrami e anëtarë të Kabinetit të tij dhe janë njoftuar se nuk është harruar çështja e Ligjit për vitet e 90-ta, por janë duke u analizuar çështjet dhe duke u mbledhur shënimet e duhura lidhur me këtë çështje të rëndësishme.



Pas kësaj këshilltari i MASHT për Kurrikul, z.Osman Buleshkaj ka prezantuar dokumentet e kësaj Konference. Ai ka shpalosur angazhimet nëpër vite rreth Kurrikulit. Ai ka cekur se është nisur me 10 shkolla për të vazhduar me 95 të tjerë këtë vit e me qëllim që duke parë se është vlerësuar mirë ky aktivitet atëherë të startohet në vitin e ardhshëm shkollor në të gjithë shkollat me Kurrikulin e ri një pjesë të Arsimit Parauniversitar dhe pastaj gradualisht do të përfshihet i tërë sistemi arsimor me Kurrikulin e ri.